



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:149093

Datë: 24.11.2022

Numri i dokumentit: 03684147

C.nr.1023/21

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim Balaj, me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi në çështjen kontestimore të paditësve E.M dhe F.V - Rastevica nga Gjakova, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, rruga “Skenderbeu”, nr.74, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA, me seli në Gjakovë, lidhur me çështjen juridike kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë, jashtë seancës, me datë 24 nëntor 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësve E.M dhe F.V - Rastevica nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – DKA, që:

-Paditëses E.M që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim (shujta ditore) për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 01.06.2021, për 368 ditë të prezencës në punë të ia paguajë shumën prej 736.00 euro, me kamatë ligjore 8% në vit, e cila llogaritet nga data 08.07.2021 (nga data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive,

-Paditëses F.V – Rastavica, që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim (shujta ditore) për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 01.06.2021, për 368 ditë të prezencës në punë të ia paguajë shumën prej 736.00 euro, me kamatë ligjore 8% në vit, e cila llogaritet nga data 08.07.2021 (nga data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive,

si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 176.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tyre kanë ushtruar padi me datë 08.07.2021, të cilën e kanë precizuar me datë 11.11.2022, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA me

seli në Gjakovë, më të cilën kanë kërkuar që të obligohet e paditura, që paditëses E.M të ia kompensojë shumën prej 736.00 euro, dhe atë në emër të ushqimit në punë për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 01.06.2021, për secilën ditë prezentë në punë nga 2 (dy) euro, me kamatë prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë, paditëses F.V - Rastevica, të ia kompensojë shumën prej 736.00 euro, dhe atë në emër të ushqimit në punë për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 01.06.2021, për secilën ditë prezentë në punë nga 2 (dy) euro, me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë, për secilën ditë prezentë në punë nga 2 (dy) euro, me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë. E paditura në bazë të nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive, nënshkruar në mes Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK me datë 18 prill 2017, dhe neni 35 pika 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.01/B, nr. prot.105, e datës 22 janar 2021, ka për obligim që paditësve të iu kompensoj ushqimin gjatë orarit të punës dhe atë dy (2) euro për çdo ditë të paraqitur në punë. Paditësja E.M nga data 01.09.2019, e deri me datë 01.06.2021 ka vijuar 368 ditë të pranisë në punë, paditësja F.V - Rastevica nga data 01.09.2019 e deri me datë 01.06.2021 ka vijuar 368 ditë të pranisë në punë. Ka parashtruar se nga koha e hyrjes në fuqi e kontratës kolektive të arsimit e deri me tani, kjo kontratë nuk është ekzekutuar në tërësi, e për këtë kanë propozuar që kërkesëpadia e paditësve të aprovohet në tërësi. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak, ka proceduar tek e paditura aktvendimin C.nr.1023/2021 të datës 24.08.2021, për dhënien e përgjigjes në padi, të cilën e paditura e ka pranuar me datë 08.09.2021, me çka konstatohet nga fletë kthesa e dorëzuar me anë të shërbimit postar të gjykatës, ndërkaq përgjigje në padi ka parashtruar me datë 30.05.2022, pra pas kalimit të afatit ligjor për paraqitjen e të njëjtës, përkundër paralajmërimit të pasojave ligjore për mos paraqitjen e saj.

Në përgjigje në padi, e paditura nder të tjera ka parashtruar se e kundërshtojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetimin se me dispozitat kalimtare të nenit 45 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë datë 22.01.2021, është paraparë që MASH, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studenteve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitës së nenit 35, paragrafët 5, 7 dhe 11, kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo me vonë se viti 2023, andaj i propozon gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pabazuar.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqësore të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nuk është kontestues se paditësit janë të punësuar tek e paditura, e po ashtu nuk ishte kontestuese se pagimi i shpenzimeve të ushqimit për periudhën e kërkuar nuk iu është ekzekutuar.

Kontestuese mbetet pamundësia financiare për pagimin e këtyre kompensimeve nga ana e të paditurës në drejtim të tani paditësve, e që në këtë rast gjykata u lëshua vetëm në vërtetimin e faktit kontestues në këtë procedurë.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar si e tillë u aprovua.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënie të vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit ta kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*, derisa në nenin 329 par. 1 të LPK-së parashihet që: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, andaj gjykata provave që kishin të bënin me vërtetimin e këtyre fakteve, iu fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre. Gjykata erdhi në përfundim se paditëseve i takon shuma si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë duke bërë përlllogaritjen e secilës ditë të prezencës në punë, me shumën që i takon sipas dispozitës së lartcekur, në shumë prej 2,00 për një ditë pune, pasi që nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, i lëshuar nga Shkollën “Shaban Golaj” në fshatin Lipovec, Komuna e Gjakovës, me nr.Prot. 243/21 i datës 01.06.2021, vërtetohet se paditësja E.M për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 01.06.2021, ka vijuar 368 ditë pune, paditësja F.V - Rastovica për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 01.06.2021, ka vijuar 368 ditë pune. Po ashtu nga kontrata e punës për paditësen E.M, e lëshuar me datë 01.09.2015, në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me numër, Leg.nr.1761/2021 e datës 28.05.2021, vërtetohet se paditësi është e punësuar në shkollën “Shaban Golaj” në Gjakovë si mësimdhënës i Matematikës -Tik, me kontratën e punës për paditësen F.V, e lëshuar me datë 01.09.2016, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet se paditësi është i punësuar në shkollën “Shaban Golaj” në Gjakovë si mësimdhënës i Mësimit Klasor.

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me mungesën e mjeteve buxhetore, gjykata e vlerësoj të pambështetje, pasi që zbatueshmëria e kontratave kolektive të arsimit në Kosovë, ajo e datës 18.04.2017, si dhe e datës 22.01.2021, është paraparë saktësisht në nenin 2 të tyre, andaj për gjykatën ky pretendim ishte jo relevant për vendosje ndryshe.

Gjykata lidhur me kamatën ka vendosur duke u bazuar në nenin 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 paragrafi 1, të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ku lartësia e shpenzimeve iu referohen shumave si për përpilimin e padisë shumë prej 156.00 euro si dhe taksa për padi shumë prej 20,00 euro, e gjithsejtë shumë prej 176.00 euro.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.1023/21, me 24 nëntor 2022

GJYQTARI  
Durim BALAJ

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.